



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 572, datë 6.10.2021

P Ë R

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.212, DATË 11.3.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT
TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT
TË OBJEKTEVE ARSIMORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, pika 3, shkronja "b", nënndarja "i", 16 dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministrit i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.212, datë 11.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:
 - a) Në pikën 2, shifra "... 5 130 260 797 (pesë miliardë e njëqind e tridhjetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH ..." zëvendësohet me "... 5 001 173 797 (pesë miliardë e një milion e njëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH ...".
 - b) Në shkronjën "a", të pikës 2, shifra "... 4 125 706 878 (katër miliardë e njëqind e njëzet e pesë milionë e shtatëqind e gjashtë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekësh pa TVSH ..." zëvendësohet me "... 3 996 619 878 (tre miliardë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekësh pa TVSH ...".

2. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi,
ZËVENDESKRYEMINISTRI

ARBEN AHMETAJ

**ZËVENDESKRYEMINISTRI
DHE MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE**

ARBEN AHMETAJ